Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

01-020/01-0041377/26
02.10.2026

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opstine/Municipal Assembly

Në mbështetje të nenit 11 nenit 12 paragrafi 1 dhe 2, shkronja d), neni 51, paragrafi 1 dhe nenin 53 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 3 paragrafi 2, neni 7,8,9 dhe 10, i Udhëzimit Administrativ Nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, nenin 53 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe Raportin e Vlerësimit të Ligjshmërisë nr.020-10/16 të datës 16.07.2026 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe neni 14 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), i Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 i datës 03.12.2008, Kuvendi i Komunës ne mbledhjen e rregullt te mbajtur me datën; 29.09.2026, mori këtë:

V E N D I M

(Për shfuqizimin e Vendimit nr. 01-020/01-0020578/26 të datës; 04.06.2026 për zëvendësimin e anëtares së komitetit për komunitete)

Neni 1

Miratohet propozim-vendimi Nr.01-020/01-0039315/26, i datës; 11.09.2026, për shfuqizimin e Vendimit nr. 01-020/01-0020578/26 të datës; 04.06.2026 për zëvendësimin e anëtares së komitetit për komunitete,Komuna Skenderaj.

Neni 2

Shfuqizimi i vendimit të lartcekur bëhet duke u bazuar në Raportin e Vlerësimit të Ligjshmërisë nr. 020-10/16, të datës 16.07.2026 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi, 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e regjistrimit të protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit te tij ne ueb – faqen të Komunës.

Vendimi i Dërgohet :
1x1 Anëtarit të zëvendësuar,
1x1 MAPL-së,
1x1 Zyrës së Kryetarit,
1x1 Arkivit,
1x1 Dosjes.

KRYESUESJA E KUVENDIT
znj. Adelina Spahiu



IZLAZNA - OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. 020-10/28
Data 28.10.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administartion

Për:	**Sami Lushtaku**, Kryetar i Komunës së Skenderajt **Adelina Spahiu Alija**, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Skenderajt	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	**Elbert Krasniqi**, Ministër i MAPL-së **Jeton Qela**, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	**Erblin Hetemi**, Drejtor i Departamentit Ligjor, MAPL	Datë: 14.10.2026 VI-020-10/17
Zyrtaret përgjegjës: 1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	**Xhevat Tafa**, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë se Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit **Donjeta Cakolli**, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë se Akteve të Komunës	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
E nderuara Kryesuese,

Në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e komunës si në vijim:

Vendimi nr.01-020/01-0041377/26 për shfuqizimin e vendimit nr.01-020/01-0020578/26 të datës 04.06.2026 për zëvendësimin e anëtares së komiteti për komunitete
I miratuar më datë: 29.09.2026
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 05.10.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës <u>është në pajtim me legjislacionin në fuqi</u> dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

ARSYETIM

Kuvendi i Komunës së Skenderajt në mbledhjen e mbajtur me datë 29.09.2026, ka miratuar, vendimi nr.01-020/01-0041377/26 **për shfuqizimin e vendimit nr.01-020/01-0020578/26 të datës 04.06.2026 për zëvendësimin e anëtares së komiteti për komunitete.**

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Skenderajt, është bazuar në nenin 12.2, pika d) të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare nr.28, dt.04.06.2008.

Vendimi është miratuar me 19 vota për, 2 kundër dhe 0 abstenime.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë lidhur me këtë vlerësim.